



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE

Elbasan, më .01.2025

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

PROÇES-VERBAL PËR HARTIMIN E KRITEREVE

OBJEKTI I PROÇEDURËS - “Blerje Karburant (gazoil d1 + benzine) për Bashkinë Elbasan dhe institucionet vartëse (ASHPR, ASHPU,ASHS, Agjensia E Kontrollit Dhe Mbiqyrjes, Drejtoria E Pergjithshme E Arsimit Parauniversitar Dhe Drejtoria E Pergjithshme E Kultures Dhe Sportit” i ndare ne lote.

**LLOJI PROÇEDURËS - “Proçedurë e hapur mbi kufirin e larte monetar – mallra”-
Marreveshje Kuader**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Kodi
CPV:09134100-8 - Karburant diesel, 09132100-4 - Benzinë pa plumb**

VLERA TOTALE E FONDIT LIMIT - “Blerje Karburant (gazoil d1 + benzine) për Bashkinë Elbasan dhe institucionet vartëse (ASHPR, ASHPU,ASHS, AGJENSIA E KONTROLLIT DHE MBIQYRJES, DREJTORIA E PERGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DHE DREJTORIA E PERGJITHSHME E KULTURES DHE SPORTIT” me fond limit: 48.891.667 (dyzet e tetëmilion e tetëqind e nëntëdhjetë e njëmijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh , Marrëveshje Kuadër - me disa operatorë ekonomikë ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj, i ndarë në lote si mëposhtë:

Loti I: “Blerje gazoil d1 për ASHPR, ASHPU,ASHS, AGJENSIA E KONTROLLIT DHE MBIQYRJES DREJTORIA E PERGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DHE DREJTORIA E PERGJITHSHME E KULTURES DHE SPORTIT” me fond limit : 46.666.667 (dyzet e gjashtëmilion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtëmijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh.

Ky fond përbën vlerën e pritshme të kontrave që mund të lidhen gjatë marrëveshjes kuadër.

Loti II: “Blerje benzine pa plumb për ASHPR, ASHPU, DHE DREJTORIA E PERGJITHSHME E KULTURES DHE SPORTIT”, me fond limit: 2.225.000 (dymilion e dyqind e njëzet e pesëmijë) lekë pa tvsh.

Ky fond përbën vlerën e pritshme të kontrave që mund të lidhen gjatë marrëveshjes kuadër I mbajtur sot me date **.01.2025**, ne baze të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontrator Bashkia Elbasan ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Shtojca 8.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Kriteret e përgjithshme përmbajne listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 76 dhe 77 të LPP-së, nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Kriteret e përgjithshme për pranimin e operatorëve pjesëmarrës janë të pandryshueshme dhe janë vënë të njëjta me Dokumentet Standarde të Tenderit sipas Vendimit Nr. 10 Datë 23.09.2024 te miratuara nga APP.

Loti I: “Blerje gazoil d1 për ASHPR, ASHPU, ASHS, AGJENSIA E KONTROLLIT DHE MBIKQYRJES DREJTORIA E PERGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DHE DREJTORIA E PERGJITHSHME E KULTURES DHE SPORTIT”

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

1. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kriteret (a-b) jane vendosur ne perputhje me Dokumentat e Tenderit te miratuara nga APP bazuar ne Vendimit Nr. 08 Datë 23.09.2024 si dhe bazuar ne Ligjin Nr.162/2020 “Per prokurimin publik” i ndryshuar.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas shtojces 8;

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqese kopje te deklaratave te xhiros vjetore te leshuara nga administrate tatimore pergjate tre viteve te fundit, ku vlera e xhiros per te pakten nje nga vitet e periudhes se kerkuar duhet te jete **jo me e vogel se vlera e fondit limit te lotit** te prokuruar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 42 pika 3, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vendosija e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiar **2021, 2022, 2023**, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në përputhje me Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kriteri 2.2.2 është vendosur referuar nenin 43, pika 4 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar në Nenin 77 pika 3 e ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c. Vendosija e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të ketë paguar **taksat dhe tarifave vendore për vitin 2024 (këstet e maturuara)** për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB), sipas afateve të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetimin për taksat dhe tarifave vendore).

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kriteri **2.2.3** është vendosur bazuar në nenin 76, pika 2 të LPP, si dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar. Vendosija e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar që operatorët ekonomikë nuk kanë pagesa të pashlyera të taksave dhe tarifave vendore.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së perlologaritur të lotit që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

a) **Ne rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik**, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të leshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes dhe të deklaruara ne organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasi të mallrave të furnizuara,

ose

b) **Në rast se përvoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat**, si dëshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara ne organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kriteri 2.3.1 është vendosur bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; nenin 40 pika 4 dhe nenin 42 pika 3 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

2.3.2 Liçencë për tregtimin e karburanteve/lëndëve djegëse lëshuar nga pushteti vendor për të gjitha pikat e stacioneve të kerkuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40 pika 5/a të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe në Ligjin Nr.8450 dt.24.02.1999 “Për përpunimin, transportin dhe tregtimin të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar.

2.3.3 Të ketë në pronësi ose me qera 3(tre) pika karburanti, të cilat duhet të kenë detyrimisht vendodhje si më poshtë:

1 pike brenda qytetit të Elbasanit;

1 pike në aksin Elbasan- Librazhd apo Elbasan-Cerrik, përfshirë degëzimet ;

1 pike në aksin Elbasan-Tiranë apo Elbasan – Durrës, përfshirë degëzimet

Për të vërtetuar këtë operatori duhet të paraqesë aktin e pronësisë ose kontratën e qerasë shoqëruar me aktin e pronësisë të qeradhënësit.

Argumentimi: Kriteri **2.3.3** është vendosur bazuar ne nenin 77 te ligjit nr.162,date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar; nenit 40 pika 8 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe ne Ligjin Nr.8450 dt.24.02.1999 ”Për përpunimin, transportin dhe tregtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar. Kërkesa per numrin e pikave ka ardhur si rezultat i furnizimit te mjeteve te renda dhe ato zjarrefikese, e sipas nevojave te levizjes se tyre dhe shtrirjes se gjere te territorit te Bashkise Elbasan per te kryer te gjitha sherbimet, eshte e nevojshme qe OE te disponoje pikat e kerkuara. Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale kryen shërbime të ndryshme në të gjithë territorin e Bashkisë Elbasan si mirëmbajtje rrugësh, pastrim kanalah, punime për mbrojtjen e tokave bujqësore nga lumenjtë apo përrrenjtë etj. Këto punime kërkojnë prezencën e mjeteve të rënda si eskavator, fadromë, rrul etj. Territori i Bashkisë Elbasan ka një shtrirje mjaft të gjerë, ka fshatra që shtrihen në kufi me bashkitë Peqin, Cërrik, Librazhd, Gramsh e deri në kufi me Bashkinë Tiranë. Në shumë raste mjetet në varësi edhe të punimeve duhet te punojnë me ditë të tëra në një vend, çka e bën të nevojshëm furnizimin herë pas here të mjetit. Kështu psh: nëse një mjet do të shkojë për të punuar në një fshat në kufi me Bashkinë Peqin, siç mund të jetë fshati Papër, NjA Papër, fshat që shtrihet përgjatë rrugës nacionale Elbasan – Durrës dhe do ti duhet të punojë për disa ditë do të duhet të kryejë furnizime të herë pas hershme dhe nëse do të kishte vetëm një pikë furnizimi, e cila mund të ishte psh në aksin Elbasan- Librazhd, mjeti do ta kishte të pamundur furnizimin, pa llogaritur kostot financiare. I njëjti argumentim si mësipër, vlen edhe për furnizimin me karburant të mjeteve zjarrefikese ne rast renies te zjarreve.

2.3.4 Vërtetimet teknike për respektimin e normave dhe të kushteve teknike në instalimet teknologjike për depozitimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të lëshuara **nga organet e miratuara të vlerësimit të konformitetit**, të akredituara në fushën e certifikimit dhe të inspektimit teknik të linjave teknologjike në fushën hidrokarbure, i vlefshëm në datën e hapjes së ofertave.

Argumentimi: Kriteri **2.3.4** është vendosur bazuar ne nenin 77 te ligjit nr.162,date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar; nenin 40 pika 8 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar; ligjin Nr.8450 dt.24.02.1999 ”Për përpunimin, transportin dhe tregtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar; ligjin 32/2016 ”Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nënpresion”. Me anë të këtij kriteri kërkohet qe OE të vërtetojnë se e ushtrojne aktivitetin ne perputhje me kushtet dhe standartet teknike te percaktuara ne lgjislacionin e fushes.

2.3.5 Çdo operator ekonomik duhet që të sjellë bashkëngjitur me ofertën, raportet e testimit të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial "ISHTI" ose nga një laborator shqiptar ose i huaj (n.q.s është laborator i huaj materiali duhet i perkthyer dhe e noterizuar në

shqip) për artikullin Gazoil (10ppm USLD). Enti çertifikues (laboratori) duhet të jetë i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë (të paraqitet dokumenti akreditimit të laboratorit). Raportet e testimeve zyrtare duhet të jetë lëshuar brenda vitit 2024.

Argumentimi: Kriteri 2.3.5 është vendosur bazuar në nenin 77 të LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; nenin 40, pika 6, germa c, të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që OE të vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentim: Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 15, pika 3/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Specifikimet teknike hartohen nga specialisti i fushës për objektin që prokurohet. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Loti II: “Blerje benzine pa plumb për ASHPR, ASHPU, DHE DREJTORIA E PERGJITHSHME E KULTURES DHE SPORTIT”

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kriteret (a-b) janë vendosur në përputhje me Dokumentat e Tenderit të miratuara nga APP bazuar në Vendimit Nr. 08 Datë 23.09.2024 si dhe bazuar në Ligjin Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas shtojces 8;

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2.1 Kopje te deklaratave te xhiros vjetore te leshuara nga administrate tatimore pergjate tre viteve te fundit, ku vlera e xhiros per te pakten nje nga vitet e periudhes se kerkuar duhet te jete **jo me e vogel se 40 % e fondit limit te lotit te prokuruar.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; nenin 42 pika 3, nenin 43/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vendosija e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të kete paguar **taksat dhe tarifate vendore për vitin 2024 (këstet e maturuara)** për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB), sipas afateve të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetim për taksat dhe tarifate vendore).

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kriteri 2.2.2 është vendosur bazuar në nenin 76, pika 2 të LPP, si dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar. Vendosija e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vertetuar që operatorët ekonomikë nuk kanë pagesa të pashlyera të taksave dhe tarifave vendore.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se **20%** e vlerës së

perillogaritur te lotit qe prokurohet dhe qe eshte realizuar gjate tre viteve te fundit, nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

a) **Ne rastin e pervojes se meparshme te realizuar me sektorin publik**, operatori ekonomik duhet te paraqese vertetime te leshuara nga nje ent publik ose fatura tatimore te shitjes dhe te deklaruar ne organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasitë e mallrave të furnizuara,

ose

b) **Në rast se pervoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat**, si deshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi, dhe te deklaruar ne organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kriteri 2.3.1 është vendosur bazuar ne nenin 77 pika 4 te ligjit nr.162, date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar nenit 40 pika 4 dhe nenit 55, pika 4 germa b) te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

2.3.2 Liçencë për tregtimin e karburanteve/lëndëve djegëse lëshuar nga pushteti vendor per piken e stacionit te kerkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40 pika 5/a te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe ne Ligjin Nr.8450 dt.24.02.1999 ”Për përpunimin, transportin dhe tregtimin të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar.

2.3.3 Të ketë në pronësi ose me qera 1(një) pike karburanti, e cila duhet te kete detyrimisht vendodhje brenda territorit te qytetit te Elbasanit.

Për të vërtetuar këtë operatori duhet të paraqesë aktin e pronësisë ose kontratën e qerasë shoqëruar me aktin e pronësisë të qeradhënësit.

Argumentimi: Kriteri 2.3.3 është vendosur bazuar ne nenin 77 te ligjit nr.162,date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar; nenit 40 pika 8 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe ne Ligjin Nr.8450 dt.24.02.1999 ”Për përpunimin, transportin dhe tregtimin të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar.

2.3.4 Vërtetimin teknik për respektimin e normave dhe të kushteve teknike në instalimet teknologjike për depozitimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të lëshuara nga organet e miratuara të vlerësimit të konformitetit, të

akredituara në fushën e certifikimit dhe të inspektimit teknik të linjave teknologjike në fushën hidrokarbure, i vlefshëm në datën e hapjes së ofertave.

Argumentimi: Kriteri 2.3.4 është vendosur bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; nenin 40 pika 8 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar; ligjin Nr.8450 dt.24.02.1999 “Për përpunimin, transportin dhe tregtimin të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar; ligjin 32/2016 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nënpresion”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që OE të vërtetojnë se e ushtrojnë aktivitetin në përputhje me kushtet dhe standartet teknike të percaktuara në Ligjislacionin e fushës.

2.3.5 Çdo operator ekonomik duhet që të sjellë bashkëngjitur me ofertën, raportet e testimit të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial "ISHTI" ose nga një laborator shqiptar ose i huaj (n.q.s është laborator i huaj materiali duhet i perkthyer dhe e noterizuar në shqip) për artikullin Gazoil (10ppm USLD). Enti çertifikues (laboratori) duhet të jetë i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë (të paraqitet dokumenti akreditimit të laboratorit). Raportet e testeve zyrtare duhet të jetë lëshuar brenda vitit 2024.

Argumentimi: Kriteri 2.3.5 është vendosur bazuar në nenin 77 të LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; nenin 40, pika 6, germa c, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që OE të vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentim: Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 15, pika 3/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Specifikimet teknike hartohen nga specialisti i fushës për objektin që prokurohet. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

NJËSIA E PROKURIMIT